

Ky udhëzues shërben për të ofruar informacionet e nevojshme për të gjithë të interesuarit për të aplikuar me koncept-ide në Thirrjen “Reagimi i Shpejtë” të LevizAlbania. Udhëzuesi shpjegon hapat, procedurat, dokumentacionin e kërkuar, rregullat dhe afatet e të gjithë procesit të Thirrjes, që nga hapja e saj, fazat pasardhëse dhe deri në përfundimin e saj.

Ky udhëzues është i rëndësishëm për të gjitha ato organizata jofitimprurëse, grupe informale dhe individë që janë të interesuar të aplikojnë pranë LevizAlbania. Të gjithë janë të lutur që për çdo informacion apo paqartësi të na shkruajnë në [info@levizalbania.al](mailto:info@levizalbania.al) ose të kontaktojnë në numrin e telefonit +355 44 500 153.

### 1. Kush mund të aplikojë?

LevizAlbania mbështet përmes instrumentave të granteve, organizatat e shoqërisë civile (OJF)<sup>1</sup>, grupet informale<sup>2</sup> dhe individët.

Organizatat e shoqërisë civile (OJF), organizatat me bazë në komunitet, grupet e të rinjve dhe të grave, individët apo grupimet e tyre, lëvizjet qytetare, organizatat e medias, gazetarë, grupe të ndryshme interesi, etj., janë të gjithë të ftuar dhe kanë mundësinë të aplikojnë në këtë Thirrje të LevizAlbania.

### 2. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikimeve:

**Thirrja për aplikime përmes instrumentit “Reagimi i Shpejtë” qëndron e hapur përgjatë gjithë kohës. Aplikimet paraqiten në çdo kohë, sa herë dhe kur aplikantët vlerësojnë se ka lindur nevoja për të vepruar menjëherë për çështjet e identifikuar si shumë problematike dhe urgjente të lidhura me demokracinë vendore.**

Aplikimi bëhet **VETËM** në formatin **ONLINE**. Për të aplikuar ONLINE duhet të vizitoni faqen zyrtare [www.levizalbania.al](http://www.levizalbania.al) dhe të klikoni në rubrikën ‘Reagimi i Shpejtë’.

Formati i aplikimit ONLINE është i disponueshëm në fund të tekstit të Thirrjes ‘Reagimi i Shpejtë’, të publikuar në këtë rubrikë.

<sup>1</sup> Organizata të shoqërisë civile janë ato organizata që janë regjistruar dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar për organizatat jofitimprurëse dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

<sup>2</sup> Grup informal është një grupim qytetaresh aktivë që ndajnë të njëjtat vlera dhe parime, dhe që veprojnë sëbashku për të adresuar çështje e probleme social ekonomike në komunitetin dhe/ose në fushën e tyre. Grupi informal nuk është i regjistruar në gjykatë, dhe qëllimi i veprimtarisë së tij nuk është fitimprurës.

### Instruksione të rëndësishme për formatin e aplikimit ONLINE:

- Në përzgjedhjen e zonës së zbatimit, për më shumë se një (1) bashki duhet të mbani të shtypur në tastierën e kompjuterit butonin CTRL dhe më pas përmes MOUSE-it të përzgjidhni bashkitë e planifikuara. Në aplikimet përmes telefonit mobile mjafton të klikoni njëherë mbi çdo bashki për përzgjedhjen e shumëfishtë.
- Në vendosjen e vlerës financiare të kërkuar për mbështetjen e koncept-idesë, në këtë fazë të aplikimit duhet vendosur vetëm një vlerë numerike, shembull: 12500 (pa presje dhjetore, pa pika, pa viza në pjesën e poshtme të numrave apo në mesin e tyre).
- Respektoni limitin e karaktereve për secilën fushë që duhet të plotësoni. Limiti ndryshon për secilën prej fushave boshe sipas specifikimeve përkatëse, dhe në rast të tejkalimit të tij, sistemi nuk do t’ju lejojë të vijoni shkrimin.
- Aplikanti OJF, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit vendimin më të fundit të Gjykatës mbi organizatën, në formatin JPG (fotografi) ose PDF.
- Aplikanti GRUP INFORMAL, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit një CV të personit që drejton/koordinon Grupin, si dhe një CV të vetë Grupit informal (duke përfshirë aktivitete të mëparshme të grupit, si dhe emrat e anetarëve të grupit), në formatin PDF ose Microsoft Word.
- Aplikanti INDIVID, duhet të ngarkojë gjatë aplikimit CV-në përkatëse, në formatin PDF ose Microsoft Word.
- **KUJDES:** Të gjitha fushat për tu plotësuar gjatë aplikimit janë të shenjua me shenjën\* (Asterix) dhe janë të detyrueshme për tu plotësuar. Në rast të mos plotësimit të këtyre fushave nuk do të mundeni të përfundoni APLIKIMIN tuaj.
- Klikoni “APLIKO” dhe keni përfunduar.
- Pas dërgimit të aplikimit do t’ju mbërrijë në adresën e postës elektronike të vendosur në aplikim, mesazhi nga serveri i LevizAlbania: “Faleminderit që Aplikuat” dhe bashkëlidhur do të jetë një kopje e aplikimit. Mesazhi konfirmon se aplikimi juaj ka qenë i suksesshëm dhe ka mbërritur pranë LevizAlbania.

### 3. Kriteret e aplikimit

Aplikimet për instrumentin e “Reagimit të Shpejtë” duhet të plotësojnë këto dy kriteret:

- Nisma e propozuar duhet të lidhet ngushtësisht me qëllimin dhe objektivat e përgjithshëm të projektit LevizAlbania.
- Aplikanti ka identifikuar një emergjencë ose mundësi që kërkon reagim të menjëhershëm, përndryshe çështja mund të humbasë rëndësinë apo hapësirën për të vepruar dhe për të patur ndikim mbi të.

## UDHËZUES I THIRRRES “REAGIMI I SHPEJTË”

Me emergjencë do të kuptohet: *Një ngjarje e paparashikuar/e papritur që çënon interesin publik dhe që kërkon një kontribut dhe reagim të menjëhershëm nga qytetarët dhe shoqëria civile, në favor të demokracisë në nivel vendor apo kombëtar.*

Me mundësi do të kuptohet: *Një zhvillim i caktuar në jetën social-ekonomike apo politike të vendit, që mund të shfrytëzohet si përparësi nga shoqëria civile për të vënë qytetarët në lëvizje dhe për të advokuar për ndryshim me interes publik. Mundësi është edhe: një draft ligj i ri që propozohet; një koalicion i ri që formohet; një lëvizje e re qytetare; një ide e re dhe inovative që propozohet; një nevojë e re që lind; etj.*

#### **4. Madhësia e granteve dhe afati i zbatimit të projekteve përmes instrumentit ‘Reagimi i Shpejtë’:**

- Shuma e grantit mund të variojë nga **1,000** deri në **15,000** franga zvicerane.
- Afati për zbatimin e një projekti është nga **1** deri në **12** muaj.

#### **5. Rregulla të përgjithshme për aplikimin dhe informacion shtesë**

- OJF-të duhet të dërgojnë vendimin më të fundit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Grupet informale duhet të dërgojnë CV të grupit (pasqyrim i aktiviteteve të kaluara të grupit si dhe emrat e anëtarëve kryesorë të tij), si dhe CV të koordinatorit apo përfaqësuesit të grupit për këtë projekt propozim.
- Individët duhet të dërgojnë CV e tyre (vetëm CV e individit aplikant).
- Thirrja për aplikime përmes instrumentit “Reagimi i Shpejtë” qëndron e hapur përgjatë gjithë kohës. Në të mund të aplikohet sa herë dhe kur aplikantët vlerësojnë se ka lindur nevoja për të vepruar menjëherë për çështjet e identifikuar.
- LevizAlbania nuk njeh si shpenzim Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

#### **LevizAlbania kërkon nga aplikantët që në hartimin e koncept-ideve të tyre:**

- të përfshijnë **perspektivën gjinore**.
- të **bashkëpunojnë me gazetarë dhe media** për të advokuar apo për të shpërndarë në publik mesazhet kryesore.
- të **stimulojnë vullnetarizmin**.
- të konsiderojnë në koncept-ide **bashkëpunime** me organizata të tjera, individë dhe/ose grupe informale **me qëllim krijimin e koalicioneve të mundshme**.

#### **LevizAlbania NUK mbështet projekte/aktivitete që synojnë:**

- Ofrimin e shërbimeve sociale.
- Realizimin e kompetencave/detyrave të pushtetit vendor;
- Trajnime të administratës vendore.
- Projekte që planifikojnë vetëm dhe kryesisht zhvillimin e tryezave të

rrumbullakëta/seminareve që nuk sjellin rezultat konkret e të prekshëm për qytetarët.

- Koncept-ide që vijnë nga shoqatat e njësisve të qeverisjes vendore.

### 6. Hapat e Thirrjes ‘Reagimi i Shpejtë’

Mekanizmi i përzgjedhjes së projekteve të Thirrjes “Reagimi i Shpejtë” të LevizAlbania, kalon në dy faza që sigurojnë transparencë, përfshirjen e grupeve të interesit dhe cilësinë sa më të lartë të aplikimeve në përputhje me kriteret e aplikimit.

#### 6.1 Aplikimi me koncept-ide dhe vlerësimi

Aplikimi në kuadër të instrumentit ‘Reagimi i Shpejtë’ bëhet vetëm online. Aplikimi është i thjeshtë dhe ju jep mundësinë ta dërgoni atë nga kompjuteri, tableta apo aparati juaj celular.

***Kujdes! Referojuni pikës 6 të këtij udhëzuesi informues në lidhje me dokumentat shtesë që duhen ngarkuar tek aplikimi online.***

LevizAlbania do t’i përgjigjet aplikimit tuaj brenda 10-15 ditëve (ditë pune) nga momenti që ju e keni dërguar aplikimin online dhe keni marrë konfirmimin përkatës.

Kriteret kryesore për vlerësimin e koncept-ideve janë si më poshtë vijon:


- Emergjencia e lindur dhe/ose mundësia e identifikuar për ndërhyrje.
- Rëndësia dhe vlera e shtuar e ndërhyrjes së propozuar.
- Metodologjia dhe aktivitetet e planifikuara.
- Risia që paraqet ideja e propozuar.
- Përputhja e koncept-idesë me objektivat e LevizAlbania.

#### 6.2 Përgatitja dhe vlerësimi i projekt-propozimeve të plota

Koncept idetë që janë përzgjedhur në fazën e parë do të ftohen të dorëzojnë Projekt Propozimin e plotë. Vlerësimi i projekt propozimeve të plota do të bëhet mbi bazën e kriterëve të mëposhtëme:

- Reflektim i rekomandimeve të LevizAlbania ndaj koncept idesë së paraqitur.
- Vlerësim i kapaciteteve menaxhuese, dhe ekspertizës së organizatës/grupit informal/individit.
- Përputhja e buxhetit me objektivat dhe aktivitetet e projektit të paraqitur.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



ZBATUAR NGA



### 7. E Drejta e Ankimimit

Aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së një kërkesë-ankese, e cila duhet të bëhet jo më vonë se 5 pesë ditë pune nga data e dërgimit të njoftimit me shkrim nga LevizAlbania.

Kërkesë-ankesa duhet të dërgohet me shkrim (email ose postë) nga vetë aplikanti dhe të përshkruajë qartë bazën e problemit/ankimimit. Përgjigja i dërgohet ankimuesit jo më vonë se 5 pesë ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimimit.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

ZBATUAR NGA



FONDACIONI SHOQËRIA  
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



PARTNERËT SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

